



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2020:060467

Datë: 16.07.2020

Numri i dokumentit: 01027598

P.nr.108/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJE, DEGA NË ISTOG–DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-Divizioni Penal, sipas Gjyqtarit të vetëm gjykues, Arben Mustafaj, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Hale Ahmetaj, në lëndën penale kundër të pandehurit B XH nga f.sh. N K. Pejë, i akuzuar për veprën penale, “ mosveprimi sipas dispozitave gjatë epidemisë“ nga neni 250 të KPRK-se, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore ne Pejë–Departamenti i Përgjithshëm me PP/II.nr.509/20, e dt. 06.05.2020, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me dt.**14.07.2020**, në praninë e Prokurorit të Shtetit, Suada Hamza, të pandehurit B XH, gjykata të njëjtën ditë publikisht mori dhe shpalli, ndërsa me dt.16.07.2020 përpiloje këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri **B XH**, i lindur me ... ne f.sh. N K. Pejë, ku edhe banon, i biri i S dhe nënës H e gjinisë D, i martuar, babai i një fëmijë, ka të kryer fakultetin e biznesit, master ne shkencat kompjuterike, me profesion IT, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar ne bazë të letërnjoftimit me nr...., Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar me parë nga Gjykata, gjendet ne liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me datë 22.03.2020 rreth orës 20:30min ne f.sh. B K. Istog, gjate kohës se sëmundjes ngjitëse Covid 19, nuk vepron sipas vendimeve te nxjerra ne baze te dispozitave te organit kompetente, i cili cakton masat qe kane për qëllim luftimin dhe parandalimin e virusit, ne atë mënyrë qe, ne kohen e pandemisë Covid 19, edhe pse Qeveria e Kosovës ne baze te vendimit 01/09 dt. 13.03.2020 pika 6, 7 dhe 10 ishte ndaluar veprimtaria e video lojërave, edhe përkundër kësaj i pandehuri B ne kundërshtim me këtë vendim, ne lokalitetin e tij "C" organizon lojëra kompjuterike, pa masa mbrojtëse maska dhe dorëza, dhe i mbledh 10 persona për te luajtur këto lojëra, por më pas hetohet nga policia e Kosovës,

- me çka ka kryer veprën penale “ mosveprimi sipas dispozitave gjatë epidemisë “ nga neni 250 të KPRK-së,

Andaj Gjykata duke vendosur në kuptim të nenit 7,8,9,10,17,21,38,42,46,48,49, 69,70, nenit 250 të KPRK-së, dhe nenit 359, 360, 361, 365, 366,450 te KPRK-së, i shqipton.

DENIM MË KUSHT

Ashtu që:

1. Të pandehurit **B XH**, gjykata i përcakton dënim me burgim në kohëzgjatje prej **3 (tre) muajsh**, i cili dënime nuk do të ekzekutohen, ne qofte se i pandehuri brenda afatit prej **1 (një) viti**, pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë veprë të re penale.
2. I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësore të paguaj shumën prej **20 (njëzet) euro**, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej **30 (tredhjet) euro** në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Peje - Departamenti i përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka ngritë aktakuzën, me PP/IL.nr.509/2020, e dt.06.05.2020, ndaj te pandehurit B XH nga f.sh. N K. Pejë, duke e akuzuar për veprën penale, “ mosveprimi sipas dispozitave gjatë epidemisë “ nga neni 250 të KPRK-se.

Lidhur me këtë çështje juridiko-penale, Gjykata ka mbajtur shqyrtimin fillestar më datë 14.07.2020, në praninë e prokurorit të shtetit Suada Hamza dhe të pandehurit B XH.

Pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i shtetit, i pandehuri B deklaroj se e pranoj fajësinë për veprën penale për te cilën akuzohem, me vjen keq për rastin qe me ka ndodhur, lokalin e kam hapur vetëm 24 min pas kërkesës se konsumatorëve, jam i penduar për këtë veprim timin dhe është hera e parë qe kamë rene ndesh me ligjin.

Gjykata kërkon mendimin e prokurorit te shtetit, lidhur me pranimin e fajësisë se te pandehurit.

Prokurori i shtetit deklaroj se pajtohem me pranimin e fajësisë, i cili pranim ka mbështetje ne provat qe gjenden ne shkresat e lendes, dhe është bere komfor dispozitave ligjore, i propozoj gjykatës qe te njëjtin te shpall fajtor dhe te dënoj sipas ligjit dhe me rasatin e marrjes se vendimit mbi dënim, pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit ta merr si rrethanë lehtësuese.

Pas deklarimit të te pandehurit se e pranon fajësinë, dhe dëgjimin e mendimit te prokurorit të shtetit i cili u pajtua me pranimin e fajësisë, Gjykata konstatoj se i pandehuri pranon fajësinë ne mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, i pandehuri është i vetëdijshëm për pasojat dhe përparësitë e pranimit te fajësisë, si dhe te gjitha kërkesat nga neni 248 par. 1 te KPRK-së janë përmbushur, andaj gjykata aprovon në procesverbal deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit B XH.

Duke pas parasysh se gjykata, ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par.1 pika 1.1,1.2,1.3 të KPPK-së, atëherë ne këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por pas deklarimit të pandehurit se e pranon fajësinë, duke vepruar në kuptim të nenit 248 par.1 lidhur me par.4 të KPRK-së gjykata ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar se i njëjti me datë 22.03.2020 rreth orës 20:30 min ne f.sh. B K. Istog, gjate kohës se sëmundjes ngjitëse Covid 19, nuk vepron sipas vendimeve të nxjerra ne baze te dispozitave te organit kompetente, i cili cakton masat qe kane për qellim luftimin dhe parandalimin e virusit, ne atë mënyrë qe ne kohen e pandemisë Covid 19, edhe pse Qeveria e Kosovës ne baze te vendimit 01/09 dt. 13.03.2020 pika 6, 7 dhe 10 ishte ndaluar veprimtaria e video lojërave, edhe përkundër kësaj i pandehuri B ne kundërshtim me këtë vendim, ne lokalit e tij "C" organizon lojëra kompjuterike, pa masa mbrojtëse maska dhe dorëza, dhe mbledh 10 persona për te luajtur këto lojëra, por më pas hetohet nga policia e Kosovës

Andaj nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit B XH qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale “ mosveprimi sipas dispozitave gjatë epidemisë “ nga neni 250 të KPRK-se.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se të i pandehuri ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale ndaj të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës për veprën penale të kryer.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese ne kuptim te nenit 69,70 te KPRK-se.

Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin, Gjykata ka vlerësuar faktin se i njëjti ka treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimit fillestar e për me tepër ka pranuar fajësinë dhe ka shpreh keqardhje për veprën penale te cilën e ka kryer, është hera e parë qe bije ndesh me ligjin. Të gjitha këto rrethana kjo Gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese në dobi te të pandehurit. Rrethanë rënduese gjykata nuk gjeti.

Andaj nga të lartcekurat, Gjykata ka ardhë ne përfundim se dënimi i shqiptuar te pandehurit është ne përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale te tij dhe me intensitetin e rrezikimit te vlerave te mbrojtura te shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do te shërbej për arritjen e qëllimit te dënimit ne pengimin e te pandehurit ne kryerjen e veprave penale ne te ardhmen, por ai do te ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë qe te përmbahen nga kryerja e veprave penale ne përputhje me nenin 38 te KPRK-së.

Duke u bazuar ne nenin 450 par. 1 dhe 2 të KPRK-së, gjykata ka përcaktuar paushallin gjyqësor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë, konform nenit 39 par.3 nën par 3.1 të Ligjit nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 370 të KPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEGA ISTOG
DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM PENAL
P.nr.108/20 më datë 14.07.2020**

Sekretaria juridike

Hale Ahmetaj

Gjyqtari Gjykues

Arben Mustafaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Palët që në afatin ligjor kanë paralajmëruar ankesë kanë të drejtë që ankesën ta bëjnë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit. Ankesa i dërgohet Gjykatës se Apelit ne Prishtine e përmes kësaj Gjykate